



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 102/13
Prishtinë, më 12.04.2013, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadergjonaj, Jelena Bontic, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Duda Balje, Hykmete Bajrami, Sali Asllanaj, Sevdije Lama dhe Xhevdet Neziraj.

Munguan: Naser Osmani dhe Albana Fetoshi.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini, Luljetë Krasniqi, Dashurije Canolli.

Gjithashtu ishin të pranishëm: Nenad Rasic-Ministër i MPMS, Ramadan Avdiu-MF, Sami Saliuki-MPMS/DAPK, Muharrem Haziri-MPMS-DAPK, Kosum Kosumi – BM AAC, Dritan Gjonbalaj- AAC, Shqipe Krasniqi-AAC, Xhevat Azemi-AKP, Marian Nieora-AKP, Arber Ibrahimaj-AKP, Ismet Krasniqi- Sekretari i Kuvendit, Emrush Haxhiu dhe Istret Azemi nga Administrata e Kuvendit. Ramadan Islami dhe Rejhane Zylfijaj nga GIZ.

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadergjonaj, Kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, dt. 03.04.2013;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti me amendamentet e komisionit funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale;**
- 4. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar të Autoritetit të Aviacionit Civil për vitin 2012;**
- 5. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar të Agjencisë Kosovare të Pronës për vitin 2012;**
- 6. Shqyrtim i Raportit me rekomandime të grupit punues të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me Projektligjin Nr. 04/L-150 për odat e profesionistëve shëndetësor dhe amendamenteve të Komisionit funksional;**
- 7. Shqyrtimi i Kornizës Afatmesme të shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për vitin 2014-2016;**
- 8. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja theksoj se rendi i ditës miratohet pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, dt. 03.04.2013

Kryetarja konstaton se procesverbali miratohet pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti me amendamentet e komisionit funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Kryetarja sqaroi se projektligji është i harmonizuar me dy Ministrinë dhe kërkesat e Fondit Monetar dhe Bankës Botërore, poashtu është paraparë kostoja buxhetore. Amendamentet të cilat kanë ardhur nga Komisioni Funksional ngarkojnë projektligjin me implikime buxhetore shtesë.

Nenad Rasic theksoi se drafti final i projektligjit ka paraqitur balancën të cilën e ka arritur Qeveria në harmoni me kërkesat e Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Bankës Botërore. Porjekligji ka qenë i kapshëm për shoqërinë tonë, pasi që i ka paraparë të gjitha kategoritë dhe aktet nënligjore të cilat përcaktojnë disa beneficione tjera. Pjesa më e rëndësishme ka qenë pjesa teknike ku mblidhen të gjitha aplikacionet dhe bëhet verifikimi i përmbledhjeve duke konstatuar vlerën financiare të rritjes së shkallës së beneficioneve për pensionist.

Ramadan Avdiu theksoi se nga prizmi i Ministrisë së Financave aprovimi i këtyre amendamenteve do të vështirësoj dukshëm implementimin e ligjit, duhet të bëhet rishikimi i amendamenteve përkatësisht amendamentet 1, 6, 9, 10, 22 duhet të hiqen, pasi që aprovimi i tyre sjell implikime të mëdha financiare. Ligji i propozuar për pensionet konsideroj se është ndër ligjet më të mira në regjion. Pra, mundësitë e buxhetit janë që të bëhet implementimi i ligjit ashtu siç është i propozuar por jo me disa nga amendamentet, të cilat rrisin koston të paktën për 30,000,000.00 € në vit.

Kryetarja sqaroi se probleme kemi edhe disa ligje tjera sepse shumica e tyre janë të ngarkuara me kosto buxhetore nga komisionet funksionale, ndoshta më mirë do të ishte që të kemi një debat të brendshëm me komisionet funksionale të cilat ngarkojnë me kosto buxhetore ligjet gjatë amendamentimit. Njoftoi se dje është realizuar një takim me FMN ku janë diskutuar amendamentet që ngarkojnë projektligjin me koston buxhetore shtesë. Nuk ka interes të hiqen nga sistemi i skemës pensionale ata që kanë përfituar, por mbetet të diskutohen amendamentet që përmbajnë kosto buxhetore.

Sali Asllanaj konstaton se jemi përfaqësues politik të partive të ndryshme dhe pavarësisht petkut politik e kemi parasysh stabilitetin financiar të shtetit. Implikimet financiare që përmban ligji nuk përmbushin nevojat e pensionistëve mjaftueshëm. Nga ajo që është diskutuar në Parlament lidhur me njohjen e përvojës së punës të punëtorëve të larguar në vitet 89-98-të. Sipas Nenit 8 është paraparë që të nxjerret ligj në Korrik të vitit 2014. Është jashtë konceptit dhe disponimit të Parlamentit të Kosovës të cilët kanë kërkuar që të nxjerret rekomandim për tre muaj, pasi që Ministri i Arsimit deklaroj se është në procedurë të punimit ky projektligj, i cili do të mundësoj që punëtorëve arsimor dhe shëndetësor të i'u njihet përvoja e punës. Pensioni duhet të nënshtrohet të gjithë qytetarëve të Kosovës kurse ndihma sociale mund të jetë variant tjetër e cila mbulon papunësinë.

Xhevdet Neziraj mendoj se në parim në Komisionin për Buxhet dhe Financa vijnë amendamente të Komisioneve Funksionale që janë në kundërshtim dhe kjo e sjell komisionin në pozitë të vështirë. Kemi kornizën afatmesme të shpenzimeve e cila kalon në Kuvend dhe është e ditur mundësia buxhetore që të rriten pensionet e arsimtarëve, në shëndetësi, pra me disa shtresa të njerëzve mos të bëjmë politikë pasi që nuk jemi të interesuar për ligje të mira në letër por që nuk implementohen në praktikë.

Hykmete Bajrami theksoj se vërejtja e saj qëndron jo në mënyrën sesi po sillen Komisionet Parlamentare pasi që ato reflektojnë atë që po flitet nga përfaqësuesit, pikërisht kur është fjala tek

Amendamenti 6 i cili rregullon Nenin 8. Dje kemi pas një debat të gjatë në Kuvend dhe i cili ka zgjuar përkrahje të përgjithshme të rekomandimeve, por sot të mos bëhet aprovimi i këtij ligji në këtë Komision. Mendoj se Amendamenti 6 nuk e rregullon Nenin 8, sepse ky amendament thotë se çështja e punëtorëve të arsimit dhe kontributit paguesit të rregullohet me akt ligjor ose nënligjor deri më 1 Korrik 2014, kurse rekomandimet dhe shprehja e Kryeministrit është që ky status të rregullohet menjëherë. Neve si Komision na vijnë ligje që nga Ministritë të cilat nuk e marrin parasysh aspak koston buxhetore që shkaktojnë. Nuk duhet të kërkohet përkrahje prej partisë opozitare për vendimin i cili është marrë më 15 Maj 2008. Do të mundohem që të bisedoj me Komisionet apo edhe partitë e tjera që amendamenti i 6 të reflektojë rekomandimet që dalin prej debatit, ky ligj të mos kalojë por prapë të kthehet dhe të amendamentohet.

Nenad Rasic konstatoj se jeni shkalla e fundit e mbrojtës së buxhetit, e i cili është qëllim i përbashkët, në momentin kur ligji aprovohet ai është i planifikuar dhe i kyqur në buxhet. Dëshiroj të theksoi se të gjithë ata që janë larguar nga puna në vitet 90, janë të planifikuar në pjesën e dytë të ligjit, evidentimi i punëtorëve të cilët janë larguar padrejtësisht nga puna, por nuk mund të fillojmë këtë iniciativë dhe të llogarisim derisa nuk bëhet e ditur numri i saktë i tyre. Hapi i parë që do të bëjmë është aprovimi i ligjit, hapi i dytë ka të bëjë me kategorizimin e atyre që janë larguar padrejtësisht nga puna.

Latif Gashi theksoj se dëshirat dhe nevojat shumë herë janë të kundërta me mundësitë. Propozoj që të gjitha amendamentet e Komisionit Funkcional të cilat kanë implikime buxhetore të merren në shqyrtim. Ne duhet ta ndryshojmë dhe ta bëjmë ligjin funksional. Ne veprojmë në bazë të asaj sesi janë mundësitë.

Nenad Rasic sqaroj se fjala është për ligjin dhe mendoj se 1 Korriku është afat i shkurtër sepse duhet përgaditur ekipin teknik, të cilët janë të përfaqësuar nga MPMS. Pas selektimit të ligjit se sa do të jetë kostoja, do të kërkohet që ky afat të jetë deri në Janar të vitit 2015.

Ramadan Avdiu deklaroj se është afat shumë i shkurtër që të bëhet selektimi i numrit të përgjithshëm pasi që në ligjin bazë është planifikuar që të fillon më 2016, por që mund të zhvendoset për gjashtë muaj prej rekomandimit të Komisionit Funkcional.

Hykmete Bajrami sqaroj se jemi në politikë sepse jemi njerëz profesionistë dhe gjithë debati i djeshëm nuk është për t'u anashkaluar as sa për të diskutuar. Kryeministri ka kërkuar përkrahjen e kërkesës së LDK-së për implementimin e vendimit të dt. 15 Maj 2008. Nëse ai vet ka bërë politikë dhe politika e tij është vetëm për të shprehur përkrahje, por jo realizimin e këtyre të drejtave.

Hasime Krasniqi theksoj se debati i djeshëm ka qenë përkrahje për gjithë mësimdhënësit dhe punëtorët e larguar nga puna, ku të gjithë jemi pajtuar rreth njohjes së përvojës së punës. Nuk jemi pajtuar ndoshta me të gjitha rekomandimet, por çdo deputet është pajtuar për të njohur përvojën e punës duke u bazuar në vendimet konkrete të Kryeministrit. Mendoj se deputetja Bajrami, si profesioniste asnjëherë nuk do të votoj një amendament i cili vë në rrezik qëndrueshmërinë financiare të Republikës së Kosovës.

Sali Asllanaj mendoj se nuk janë vetëm punëtorët e arsimit të viteve 90 që duhet me mbrojt stabilitetin financiar të Kosovës, të shohim meritat e tyre dhe të regjistrohen si punëtorë. Deklaratat politike i kemi bërë në Parlament por kur ato duhet të shkrihen në ligj hezitohet. Evidenca e punëtorëve të arsimit mund të arrihet shumë shpejt.

Latif Gashi konstatoi se kemi problem, pasi siç duket LDK nuk e din se shteti i Kosovës ka dalur nga lufta, ai njeh mundësitë buxhetore të shtetit, ende i kemi problemet e veteranëve të luftës, të burgosurit politik dhe për hir të tyre ende nxjerren ligje. Mund të bëhet politikë por këto probleme do ti zgjedhim.

Hykmete Bajrami po flasim për punëtorët e arsimit në vitet e 91-99 dhe të cilët nuk marrin pensionin që e ka kontribuar por të moshës, asnjëherë nuk duhet të bisedohet për të tjerët pa qenë në vendin e tyre. Pjesë Zëvendës Ministrin e Financave se FMN-ja kur flet me juve a ju tregon sesa keni shpenzuar për veturë? Pasi që në raportin financiar është e dukshme sa është shpenzuar. Vit pas viti kemi ngritje të shpenzimeve të karburantit, telekomunikimit. Pra, asnjëherë nuk kursehet sepse kemi familjarizim në institucione.

Ramadan Avdiu sqaroi se është aprovuar raporti financiar për vitin 2012, kërkoj që të bëhen analiza profesionale, sepse nuk duhet të përzihet politika me profesionalizëm. Sa i përket shpenzimeve të mallrave dhe shërbimeve kemi rritje të tyre vit pas viti, me FMN të gjitha kategoritë e buxhetit diskutohen, kurse përvojën e punëtorëve askush nuk e konteston, por duhet të kornizohet vendim brenda rregullave. Është diçka tjetër përvoja e punëtorëve të arsimit apo të Trepçës dhe ajo e pensionit të parakohshëm.

Me shtatë vota për (Safete Hadërgjonaj, Jelena Bontic, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Xhevdet Neziraj, Sevdije Lama, Duda Balje), asnjë Kundër dhe asnjë Abstenim, dy anëtarë nuk morën pjesë në votim (Hykmete Bajrami dhe Sali Asllanaj) Komisioni propozoi ndryshimin e nenit 8, paragrafi 5 si në vijim:

E drejta dhe përcaktimi i kushteve dhe kriterëve për pension kontribut pagues të moshës për punëtorët e Kosovës të larguar me dhunë apo të shpallur si tepërc teknologjike pa bazë ligjore në vitet 1989 deri më 1 Janar 1999, do të rregullohet me akt ligjor apo nënligjor të veçantë deri më 1 Korrik 2004.

Ramadan Avdiu sqaroi se kompleksi Trepça ka pasur mbi 20000 punëtorë, administrata ka pasur tjera kushte krahas minatorëve, pra nuk është vetëm për minatorët por për të gjithë të punësuarit në kompleksin Trepça.

Me tetë vota për (Safete Hadërgjonaj, Latif Gashi, Jelena Bontic, Hasime Krasniqi, Xhevdet Neziraj, Sevdije Lama, Duda Balje, Sali Asllanaj), asnjë Kundër dhe një abstenim (Hykmete Bajrami) Komisioni rekomandon që të fshihet amendamenti 9 dhe 10 i komisionit funksional dhe të mbetet teksti si në Projektligj.

Kryetarja amendamenti 16 i cili ka të bëjë me nenin 13, në ligj ka qenë përcakton lartësinë kurse Komisioni funksional e ka ndryshuar në “përcakton rritjen”, nëse e analizojmë në aspektin ekonomik fjala lartësinë është më e përshtatshme.

Hykmete Bajrami konstatoj se fjala lartësi është e përshtatshme për Qeverinë sepse kjo nënkupton se ato mund edhe të ngrisin dhe të zbesin, nuk ka ndonjë ligj që lejon ngritje dhe zbritje të pensioneve prandaj pajtohem me amendamentin e Komisionit Funksional i cili thotë rritjen.

Latif Gashi mendoj se nuk ka të bëjë asgjë me atë që është thënë. Fjala lartësi nuk e ndalon rritjen por të futet në ligj rritja atëherë është obligative që çdo vit të rritet. Jam dakord që të fshihet fjala rritje dhe të vendoset lartësi.

Me gjashtë vota për (Safete Hadërgjonaj, Latif Gashi, Jelena Bontic, Hasime Krasniqi, Sevdije Lama, Duda Balje,) dy kundër (Hykmete Bajrami, Sali Asllanaj), një abstenim (Xhevdet Neziraj), Komisioni rekomandoj që të fshihet amendamenti 16 i komisionit funksional.

Me shtatë vota për (Safete Hadërgjonaj, Latif Gashi, Jelena Bontic, Hasime Krasniqi, Sevdije Lama, Duda Balje, Xhevdet Neziraj) dhe dy kundër (Hykmete Bajrami dhe Sali Asllanaj), Komisioni rekomandoj që të fshihet amendamenti dhe të mbetet neni 17 si në Projektligj.

Hykmete Bajrami pyet Ministrin e Financave në kontratën që ka me Bekteel a keni mundësi të thoni së ne rast të jostabilitetit financiar ndërprejmë punën e autostradës për një kohe dhe mbetet të vazhdohet pas dy viteve apo çështja qëndron se paguani dënim nga 25000-40000 euro nëse për shkaqe të Qeverisë apo pamundësisë së punës nga ana e kosovarëve.

Latif Gashi deklaroj se po të ekzistonte kriza në shtetin tonë nuk do të mundësohej ndërtimi i autostradave. Pra, ky nen nënkupton një gjendje të jashtëzakonshme.

Sali Asllanaj mendoj se ndërtimet që do të duhej të bëheshin nga Qeveria duhet të jenë sipas një rregulli të caktuar, një jo stabilitet financiar a tek pensionistët do të duhet të reduktohej?

Kryetarja theksoj se asnjë Qeveri, asnjë person që udhëheq atë nuk ka interes të bëjë ndërhyrje tek skemat pensionale. Është një rregull i kërkuar nga Fondi Monetar dhe po e largojmë atë që është shkruar në ligj, pra, në rast të jostabilitetit financiar dhe me qëllim të ruajtjes së disiplinës fiskale publike zbatohet neni 36 i Ligjit nr 04/L-048 të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë dhe neni 4 të Ligjit nr. 04/L-116 për ndryshim dhe plotësim.

Me tetë vota për (Safete Hadergjona, Latif Gashi, Jelena Bontic, Hasime Krasniqi, Sevdije Lama, Duda Balje, Xhevdet Neziraj, Sali Asllanaj) dhe një kundër (Hykmete Bajrami) Komisioni rekomandoj që të riformulohet neni 16 (dhe fshihet amendamenti 18) si në vijim:

Në rast të jostabilitetit financiar dhe me qëllim të ruajtjes së disiplinës fiskale publike, zbatohet neni 36 i Ligjit nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

Me gjashtë vota për(Safete Hadergjona, Latif Gashi, Jelena Bontic, Hasime Krasniqi, Sevdije Lama, Duda Balje,) dhe tre kundër (Hykmete Bajrami, Sali Asllanaj dhe Xhevdet Neziraj), asnjë Abstenim. Komisioni rekomandon që të fshihet amendamenti 22 i komisionit funksional dhe të mbetet teksti si në projektligj.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Komisionit me shtatë vota për (Safete Hadergjona, Latif Gashi, Jelena Bontic, Hasime Krasniqi, Sevdije Lama, Duda Balje, Xhevdet Neziraj) dhe dy kundër (Hykmete Bajrami dhe Sali Asllanaj) nxori këtë

Rekomandim

1. Projektligji nr. 04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti, nuk përmban implikime buxhetore shtesë, me përjashtim të neni 16.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, propozon amendamentet si në vijim:

Amendamenti 1

Neni 16 riformulohet si në vijim:

Neni 16

Reduktimet e pensioneve

Në rast të jostabilitetit financiar dhe me qëllim të ruajtjes së disiplinës fiskale publike, zbatohet neni 36 i Ligjit nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe neni 4 i Ligjit nr.04/L-116 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

Amendamenti 2

Neni 8, pas paragrafit 5, shtohet paragrafi i ri me tekstin si në vijim:

E drejta dhe përcaktimi i kushteve dhe kriterëve për pension kontributpagues të moshës për punëtorët e Kosovës të larguar me dhunë nga puna apo të shpallur si tepriçë teknologjike pa bazë ligjore në vitet 1989 deri me 1 janar 1999, do të rregullohet me akt ligjor apo nënligjor të veçantë, deri më 1 korrik 2014.

2. Amendamentet e propozuara nga Komisionin Funkcional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale për Projektligjin nr. 04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë, me përjashtim të amendamentit 6, 9, 10, 16, 17, 18 dhe 22.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, rekomandon që amendamentet 6, 9, 10, 16, 17, 18 dhe 22 të komisionit funksional, të hiqen.

4. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar të Autoritetit të Aviacionit Civil për vitin 2012

Kryetarja vlerësoj se sipas ligjit për aviacionin civil në Kosovë për çdo vit ky autoritet është i obliguar t'i paraqes raport Kuvendit poashtu në ligj është e përcaktuar përmbajtja e këtyre raporteve financiare, përkatësisht niveli i pagave, prokurimet, menaxhimin financiar dhe çështjet buxhetore. Nga raporti shohim se mjetet e shpenzuara shprehur në përqindje janë 93%, të planifikuara 750,498.00€ me shtesa të cilat janë bërë me rivlerësim të buxhetit ka pasur 789,558.00 € prej të cilave janë shpenzuar 731,568.00 €.Ky autoritet rregullativ ka inkasuar edhe të hyra në vlerë 1,498,150.00€ që janë më të mëdha krahasuar me vitin 2011. Përveç raportit na është janë sjell edhe formularët e kërkuar.

Kosum Kosumi sqaroj se buxheti i AAC për vitin 2012 ka qenë 750,498.00€, buxhet shtesë 39,060.00€. Pas rishikimit buxheti i AAC ishte 789,558.00€. Bordi mbikëqyrës ka bërë mbikëqyrjen e performancës përmes raporteve tre mujore dhe gjatë këtij buxhet i realizuar është 93 %. Poashtu janë zbatuar shpenzimet sipas planit të rrjedhjes së parasë, raportet tre mujore të drejtorit të përgjithshëm janë mekanizëm shumë i efektshëm që garantojnë vazhdimësi të mbikëqyrjes. Vlen të theksohet se Raporti i Auditorit të Përgjithshëm për pasqyrat financiare ka qenë shumë pozitiv, ka disa tejkalime të shpenzimeve në disa nënkategori të cilat janë kompenzuar me kursime në kategoritë e tjera.

Xhevdet Neziraj kërkon sqarim për kategorinë Mallra dhe Shërbime pasi që vërehen disa tejkalime?

Hasime Krasniqi shpreh shqetësim për nënkategoritë ku vërehen tejkalime të shpenzimeve nga ajo që është paraparë, poashtu tek udhëtimet jashtë vendit vërehet ngarkesë e buxhetit, ndërsa lidhur me pagat shohim se ato janë shumë të larta.

Dritan Gjonbalaj arsyetoi se shpenzimet e udhëtimit kanë pasur realizim 176 % prej të cilave një pjesë e madhe e shpenzimeve të udhëtimit janë për trajnim të personelit. Në projektin e binjakëzimit të AAC të Kosovës dhe atij të Francës, Republika e Kosovës ka pasur detyrim të mbulojë një pjesë të shpenzimeve të këtij projekti. Vlerësojmë faktin se gjatë vitit të kaluar ka pasur aktivitete më të mëdha të inspektorëve në Republikën e Shqipërisë. Për blerjet e tjera është shpenzuar 174 %, AAC ka ndërruar lokacionin dhe ka kaluar në zyra më të mëdha e kjo gjë ka ndikuar që të rriten shpenzimet për zyra. Gjithashtu është kategoria ushqim dhe pije ku janë rritur shpenzimet për shkak të numrit të madhë të delegacioneve të huaja. Derivate dhe lëndë djegëse në 148% ka ndikuar ndryshimi i lokacionit, lëvizja me makina apo kostoja 7.9 euro karburant për veturë. Tek mirëmbajtja ka pasur rritje sepse AAC-ja ka qenë e detyruar të bëjë lyerjen e objektit të vjetër duke e sjell në gjendje të mëparshme. Shpenzimet e përfaqësimit tregojnë se kemi pas vizita të ndryshme me numër të madhë të personave.

Latif Gashi deklaroj se shqetësimet e ngritura nga kolegët janë të rëndësishme, në faqen 45 tek raporti i punës janë të paraqitura prokurimet. Pavarësisht asaj se nuk është justifikim i nevojshëm ligjor konsideroj se është raporti i mirë financiar.

Pas diskutimeve, Komisioni njëzëri nxorri këtë :

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratoj Raportin vjetor financiar i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës për vitin 2012.

5. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar të Agjencisë Kosovare të Pronës për vitin 2012

Kryetarja konstatoi se AKP-ja është e obliguar sipas ligjit të pasqyroj të hyrat nga buxheti dhe të hyrat nga donatorët, në raportin e ofruar kemi të gjitha të hyrat dhe shpenzimet poashtu është sjell edhe forma e kërkuar e standardizimit të të dhënave. Buxheti për vitin 2012 ka qenë 1,806,761.00€, prej të cilave janë shpenzuar 1,746,342.00€ apo shprehur në përqindje 96.64 % të mjeteve të buxhetit.

Marian Nieora theksoj se Agjencioni është duke vazhduar punën shumë mirë, duke rritur realizueshmërinë e objektivave.

Xhevat Azemi prezentoj shkurtimisht raportin e shpenzimeve të AKP-së sipas të dhënave të detalizuara në kategoritë dhe nënkategoritë ekonomike të shpenzimeve. AKP-ja financohet edhe prej donatorëve dhe niveli i shpenzimeve të buxhetit të donatoreve është 97.43 %.

Latif Gashi konsideroj se raporti është shumë profesional ku përveç të hyrave janë pasqyruar edhe planifikimet dhe shpenzimet në kuadër të buxhetit të planifikuar të agjencionit.

Hykmete Bajrami konstatoj se raporti plotëson të gjitha kushtet dhe kriteret të cilat kërkohen me ligj.

Xhevdet Neziraj vlerësoj raportin e përgaditur mirë dhe më të dhëna të detalizuara. Megjithatë Auditori tek disa Agjencione nxjerr te meta, sidomos te mallra dhe shërbimet, pasi që këtu është pozicion pak i mangët.

Xhevat Azemi sqaroj se ka përfunduar vlerësimi i Auditorit pa mangësi në buxhet, kurse çështja e arritshmërisë së përqindjes nuk do të thotë se nuk kemi pas nevojë më shumë për mjete shtesë, vlen të përmendet amortizimi i veturave ku është hargjuar pjesë më e madhe e mjeteve por kemi arritur të bëjmë një zgjidhje përmes donacioneve të ndryshme duke bërë kështu lehtësim të buxhetit për vitin 2013.

Arber Ibrahimaj sqaroi se niveli i shpenzimeve për Mallra dhe Shërbime që është më i ulët krahasuar me shpenzimet tjera është për shkak të vonësës së veturave që i kemi pranuar.

Pas diskutimeve, Komisioni njëzëri nxorri këtë:

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratoj Raportin vjetor financiar i Agjencisë Kosovare të Pronës për vitin 2012.

6. Shqyrtim i Raportit me rekomandime të grupit punues të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me Projektligjin Nr. 04/L-150 për odat e profesionistëve shëndetësor dhe amendamenteve të Komisionit funksional

Kryetaraj njoftoi se grupi punues ka përfunduar punën dhe ka propozuar ndryshimet më të mundshme për këtë projektligj, ku është rregulluar pjesa financimit, llogaridhënies së odave dhe statusit të tyre.

Me tetë vota për (Safete Hadergjonaj, Latif Gashi, Jelena Bontic, Hasime Krasniqi, Sevdije Lama, Duda Balje, Xhevdet Neziraj, Sali Asllanaj) një abstenim (Hykmete Bajrami), Asnjë Kundër, nxorri këtë :

Rekomandim

3. Projektligji nr. 04/L-150 për odat e profesionistëve shëndetësor, nuk përmban implikime buxhetore shtesë, me përjashtim të nenit 1, paragrafit 1 dhe 4 të nenit 4, nenit 37, paragrafit 1.2. të nenit 38, nenit 40, nenit 45 dhe paragrafit 1 të nenit 48.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, propozon amendamentet si në vijim:

Amendamenti 1

Në nenin 1 dhe në tërë tekstin e projektligjit ku përdoret teksti “*odat e profesionistëve shëndetësorë si organizata të pavarura dhe profesionale*”, zëvendësohet me tekstin “**odat e profesionistëve shëndetësorë si organizata të pavarura profesionale që ushtojnë veprimtari publike**”.

Amendamenti 2

Neni 4

Paragrafi 1 riformulohet si në vijim:

Odat janë organizata të pavarura profesionale që ushtojnë veprimtari publike dhe kanë cilësinë e personit juridik me të drejta dhe detyra të përcaktuara me këtë ligj, aktet nënligjore, legjislacionin tjetër përkatës dhe Statutin e Odave.

Paragrafi 4, hiqet.

Amendamenti 3

Neni 37, riformulohet si në vijim:

Neni 37

1. Mjetet për themelimin dhe funksionimin e odës sigurohen nga:
 - 1.1 Buxheti i Republikës së Kosovës për fazën kalimtare tre vjeçare.
 - 1.2 Mjetet e realizuara sipas nenit 38 të këtij ligji, për tri vitet e para nga hyrja në fuqi e këtij ligji, derdhen në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Amendamenti 4

Neni 38, në paragrafin 1.2, fshihet teksti “ *Kompensimin (taksën) për anëtarët e odës*”. (Pjesa tjetër e tekstit mbetet.)

Amendamenti 5

Neni 40 riformulohet si në vijim:

Neni 40

1. Mjetet e Odës derdhen në xhirollogarinë e Odës dhe menaxhohen si në vijim:
 - 1.1. Për tri vitet e para kalimtare nga hyrja në fuqi e këtij ligji, mjetet sigurohen nga Buxheti i Ministrisë së Shëndetësisë në pajtim me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.
 - 1.2. Të hyrat e parapara për financim të Odës sipas nenit 38 fillojnë të zbatohen me themelimin e Odës në pajtim me këtë ligj dhe për tri vitet e para derdhen në Buxhetin e Republikës së Kosovës. Mjetet e grumbulluara në vitin e tretë mbahen në Buxhetin e Republikës së Kosovës si mjete të alokuara për Odën sipas Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi, të cilat derdhen në xhirollogarinë e Odës me fillimin e vitit të katërt me qëllim të funksionimit të Odës.
 - 1.3. Pas vitit të tretë, Oda vetëfinancohet sipas mënyrës së paraparë me këtë ligj.
2. Oda e ka xhirollogarinë e vetë të hapur nga Thesari.
3. Kryetari i Odës është përgjegjës financiar i Odës.
4. Oda është përgjegjëse për punën e saj me tërë pasurinë që disponon.

Amendamenti 6

Neni 45 i projektligjit riformulohet si vijon:

Neni 45

1. Për financimin e aktiviteteve dhe raportimet financiare të Odës duhet të zbatohen rregullat e afarizmit financiar dhe kontabilitetit në përputhje me ligjet e Kosovës.
2. Odat e profesionistëve që shfrytëzojnë mjetet e Buxhetit të Republikës së Kosovës dhe mjetet tjera publike, duhet të zbatojnë dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Ligjit për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës. Mjetet e shfrytëzuara auditohen nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm në përputhje me legjislacionin në fuqi.
4. Komisioni për Buxhet dhe Financa, i rekomandon Komisionit funksional të bëjë riformulimin e paragrafit 1 të nenit 25 dhe paragrafit 1 i nenit 48, si në vijim:

Neni 25, paragrafi 1 të riformulohet si në vijim:

1. Në procedurë para Këshillit Etik të Odës, zbatohen dispozitat e Ligjit për procedurën administrative, në lidhje me thirrjen e palëve, sigurimin e provave, dëgjimin e palëve, përgatitjen e procesverbaleve dhe procedurat tjera.

Neni 48, paragrafi 1 të ndryshohet si në vijim:

1. Statuti i Odës, pas miratimit nga Odat sipas neneve 46 dhe 47 i dërgohet Ministrisë së Shëndetësisë për miratim.
5. Amendamentet e propozuara nga Komisionin Funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale për Projektligjin nr. 04/L-150 për odat e profesionistëve shëndetësor, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë, me përjashtim të amendamentit 27, 28, 30 dhe 33.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, rekomandon që amendamenti 27, 28, 30 dhe 33, të hiqen.

7. Shqyrtimi i Kornizës Afatmesme të shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për vitin 2014-2016

Kryetarja theksoj se gjatë analizës se kornizës shohim se për vitin 2014 ka ndryshime zakonisht tek pjesa që është e ndarë për Administratën e Kuvendit (ka rritje të buxhetit në kategorinë Paga dhe Mëditje). Për më tepër kërkoj sqarime nga sekretari i Kuvendit.

Ismet Krasniqi sqaron se buxheti i Kuvendit merr pjesë në buxhetin e shtetit me një përqindje prej 0.052% kurse propozim i yni është rritja e tij në 0.002%, jemi në një buxhet të ulët i cili nuk ofron efikasitet të punës për deputet. Tek Administrata është paraparë një rritje, por nuk është aq e lartë nëse bëhet kompensimi i pagave përmes ligjit për paga. Tek Mallrat dhe Shërbimet është shuma 96,500.00€ kurse tek subvencionet është paraparë shuma 30,000.00€ për blerjen e skanerit të Mamografisë.

Latif Gashi konstatoi se duhet bërë një analizë tek kategoria Paga dhe Mëditje ku kërkesa buxhetore është për 422,000.00€ duke i'u referuar ligjit të tanishëm. Si mund të paragjykohet miratimi i Ligjit dhe harmonizimi me atë ligj kur nuk ekziston ligji? Kemi nevojë për më tepër kohë.

Kryetarja deklaroj se tek Administrata e Kuvendit parashihet rritja e stafit prej pesë anëtarëve, e arsyeshme do të ishte ndarja e mjeteve dhe specifikimi i këtyre pozitave. Do të duhej të vlerësohej efektshmëria e njerëzve që po pranohen në Kuvend. Tek kërkesa për shërbyesit civil është paraparë një kosto shtesë buxhetore për implementimin e ligjit për pagat e shërbyesve civil.

Hasime Krasniqi propozoj që të i'u lejohen mjetet për punësimin e pesë pozitave të tjera përderisa ekziston shumë e paraparë në harmonizim me ligjin për pagat e shërbyesve civil.

Hykmete Bajrami vlerësoj se mungon mbështetja e deputeteve nga stafi i administratës së Kuvendit, jemi Parlamenti më i zhveshur në rajon për shkak të mungesës së ndihmës profesionale. Një organogram që u përmend është i rëndësishëm të i'u shpërndahet të gjithë deputeteve se ku mund të adresohen çështjet e caktuara. Sa i përket shtesës për harmonizimin e ligjit, Komisioni për Buxhet dhe Financa do të duhet të ketë parasysh se a dëshiron të trajtoj këtë çështje në mënyrë të fragmentuar apo në konsultimi me MF që të gjitha kërkesat të inkorporohen në fondin e 20 mil €.

Ismet Krasniqi sqaroj se mund të organizohet një takim me drejtorët për ofrimin e informatave të sakta dhe të nevojshme, kurse Zyra e Hulumtimeve është themeluar prej datës 1 Janar 2013, e cila përbehet prej 8 zyrtare të cilët kanë përfunduar 34 hulumtime për deputet. Pranë zyrës së sekretarit është paraparë që të punësohen katër punëtorë nga të cilët është realizuar vetëm një. Niveli i zyrtarit nëdrilidhës me institucionet e pavarura është më tepër teknik-informativ.

Hykmete Bajrami kërkoj që këto hulumtime të bëhen publike në web faqe të Kuvendit, që mund të shfrytëzohen për nevojat e deputetëve.

Ismet Krasniqi sqaroj se duhen gjashtë muaj deri tek vlerësimi i efekteve të këtyre hulumtimeve dhe pastaj të startohet me publikim.

Latif Gashi konsideroj se është kërkesë jo shumë e ngutshme dhe në bazë të diskutimeve besoj se duhet të trajtohet dhe caktohet si një pikë e veçantë e rendit të ditës, se bashku me informacionet shtesë në mënyrë që të mos bëhet veprim i cili do t'i'u hapte rrugë institucioneve të tjera në emër të harmonizimit të ligjit për shërbyesit civil.

Istret Azemi sqaron se Administrata e Kuvendit ka paraparë që numri prej pesë të punësuarve për vitin 2014 të jetë : dy në zyrë të sekretarit, një në harmonizim të gjuhës serbe, një shërbime teknike dhe një në IT.

Kryetarja theksoj se shuma për Mallra dhe Shërbime duhet të zvogëlohet dhe jo të rritet.

Istret Azemi arsyetoj se shuma prej 91,500.00€ që po kërkohet janë për disa iniciativa të reja, të parapara që në ndërtesën e Kuvendit të ketë qasje në gjithë ndërtesën me Wirlees.

Pas diskutimeve, Komisioni njëzëri nxorri këtë:

Rekomandim

- I. Të miratohet Raporti i shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për vitin 2012.
- II. I rekomandohet Kryesisë së Kuvendit, të rishikojë Vendimin e Kuvendit të Kosovës nr.02/229-1/06 të datës 17 korrik 2006, për vazhdimin e punimeve për ndërtimin e Qendrës Administrative Protokollare në Gërmi, dhe Kuvendit t'ia paraqet propozimi

Mbledhja përfundoi në orën 13:20

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryesuesja e Komisionit

Safete HADERGJONAJ